



MINISTRIA E TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS

## KONTRATË KONCESIONI

E FORMËS BOT (NDËRTIM, SHFRYTËZIM DHE TRANSFERIM) PËR  
NDËRTIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE TRANSFERIMIN E NJË PORTI TË  
LLOJIT MBM NË PORTO ROMANO, DURRËS

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS  
DHE  
SHOQËRIA KONCESIONARE PORTI MBM (MULTY BUOY MOORING)

## PËRMBAJTJA

	Faqja
<b>Dispozita të përgjithshme</b>	
1. Përkufizime.....	9
2. Interpretime.....	11
3. Objekti i Koncesionit.....	12
4. Kërkitime dhe studime .....	12
<b>Dhënja dhe dorëzimi i koncesionit</b>	
5. Dhënja e koncesionit .....	13
6. Periudha e koncesionit.....	13
7. Data Efektive e Kontratës .....	14
8. Rastet e zgjatjes së periudhës së koncesionit .....	14
9. Autorizime , leje dhe licenca .....	14
10. Dorëzimi i mjediseve të Koncesionit dhe lehtësirave.....	15
11. Procedura e dorëzimit .....	15
<b>Masat Financiare</b>	
12. Të ardhurat e koncesionarit .....	18
13. Tarifa e Koncesionit .....	18
14. Tarifat e aplikuara.....	18
15. Financimi i koncesionit.....	19
16. Vlera e investimit dhe riinvestimit .....	19
17. Kontrollat .....	20
<b>Të drejtat dhe detyrimet e palëve</b>	
18. Detyrime të autoritetit kontraktues .....	20
19. Plani i projektit.....	21
20. Programi i punimeve .....	21
21. Vonesat në zbatim .....	21
22. Zgjidhja e pasojave të vonesës .....	22
23. Vonesat në arritjen e Planit të Projektit për shkak të Autoritetit.....	22
24. Monitorimi dhe mbikqyrja .....	23
25. Shërbimet .....	23
26. Zgjidhja e konflikteve për shërbimet.....	24
27. Përmirësimi i Shërbimeve .....	24
28. Neni 28.....	24
29. Regjistra dhe raporte.....	25
30. Kontrolli i ndryshimit të Kontratës.....	25
31. Personeli .....	25
32. Të drejtat e koncesionarit .....	26
33. Detyrime të përgjithshme të koncesionarit.....	26

34. Detyrime të posaçme të koncesionerit .....	28
35. Forca Madhore.....	29
36. Pasojat e Ngjarjeve të Forcës Madhor.....	30
37. Neni 37.....	30
38. Dëmshpërblimi.....	31
39. Konfidencialiteti .....	31
40. Kufizimet në përgjegjësi .....	32
41. Sigurimi .....	32
42. Garancitë e Autoritetit .....	32
43. Garancitë e Koncesionerit .....	33
44. Sigurim i kontratës .....	33
45. Nën – kontraktimi .....	34
46. Transferimi i Kontratës .....	34
<b>Përfundimi i kontratës</b>	
47. Mbarimi i kontratës .....	35
48. Zgjidhja e Kontratës nga Autoriteti.....	35
49. Zgjidhja e Kontratës nga Koncesionari.....	36
50. Njoftimi i përfundimit .....	36
51. Procedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjes .....	36
52. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.....	37
53. Procedura e shkallëzimit.....	37
54. Penaliteti në rast mospërmbushje detyrimesh.....	38
55. Pasoja e përfundimit .....	38
<b>Dispozitat përfundimtare</b>	
56. Marrëveshja e palëve.....	39
57. Ndarja .....	39
58. Sigurime të mëtejshme .....	39
59. Kontrata si një e tërë .....	39
60. Njoftimet .....	40
61. Ligji rregullues dhe juridiksioni .....	40
62. Praktikat e korruptuara, konflikti i interesit dhe kontrolli i procesverbaleve....	41
63. Hyrja në fuqi .....	41

## ANEKSET

Aneksi 1 Pozicioni Gjeografik .....	42
Aneksi 2 Plani i Projektit .....	45
Aneksi 3 Plani i Biznesit .....	46
Aneksi 4 Plani i Riinvestimit .....	47
Aneksi 5 Certifikatë Garancie Kontrate .....	48

KJO KONTRATË, lidhet sot më datë \_\_\_\_\_ Qershor 2015

NDËRMJET:

**Ministrisë së Transportit dhe Infrastukturës të Republikës së Shqipërisë** (në vazhdim referuar si “**Autoriteti**”, përfaqësuar nga Z. Edmond Haxhinasto, Ministër, Titullari i Autoritetit.

DHE

**Shoqërisë Koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”**, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 21.04.2015, me seli në adresën Porto Romano, Durrës, me numër unik identifikimi (NUIS) L51621501S, përfaqësuar nga Administratori Z. Arjan Dhimetrika,

Shoqëria Koncesionare është krijuar në përputhje me ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, si ‘**subjekt për qëllime të veçanta**’ nga Ortakët “Adriatic Petroleum Platform PTE LTD”, “ATEC S.r.l”, “Mampey Offshore Industries B.v” dhe “Salillari”

Qëllimi i krijimit të këtij shoqërie, është realizimi i kontratës koncesionare “të formës BOT (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës”.

#### KUSHTE PARAPRAKE:

Në zbatim të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, si Autoritet Kontraktues, zhvilloi më datë 19.01.2015 , procedurën përkatëse për dhënien me koncesion të formës BOT (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës

- *Procedura e sipërcituar filloi si rezultat i propozimit të pakërkuar të subjektit “Adriatik Petroleum Platform PTE.LTD” për marrjen në koncesion dhe partneritet publik privat me qëllim menaxhimin dhe zhvillimin teknologjik për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës për një periudhë 35 vjeçare.*
- *Autoriteti shpalli Dokumentet Standarde të Procedurës Përzgjedhëse Konkurruese për Dhënien me koncesion të formës BOT (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) “për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës”*
- *Shoqëria “Adriatik Petroleum Platform PTE.LTD” paraqiti në formë elektronike, një propozim në përgjigje të procedurës konkurruese në lidhje me “Dhënien me koncesion formës BOT (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) “për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës”, propozim i cili pasi u trajtua u pranua nga Autoriteti.*
- *Bashkimi i Shoqerive “Adriatic Petroleum Platform PTE LTD”, “ATEC S.r.l”, “Mampey Offshore Industries B.v” dhe “Salillari” u përzgjedh si fitues në fund të procesit të vlerësimit si pasojë e përmbushjes së kërkesave të specifikuara në DSK në përputhje me përcaktimet e bëra nga Autoriteti;*
- *Me shkresën nr. 1492/5 Prot. datë 14.04.2015, Autoriteti i ka dërguar Koncesionarit, shoqërisë “Adriatik Petroleum Platform PTE.LTD” SHPK, Njoftimin e Fituesit’.*
- *Në datën 21.04.2015 me qëllim lidhjen dhe zbatimin e kontratës nga koncesionari u bë regjistrimi në QKR i Shoqërisë Koncesionare Porti MBM (Multy Buoy Mooring)*
- *Si përfundim, Autoriteti dhe Shoqëria Koncesionare Porti MBM (Multy Buoy Mooring) përfshihen në këtë kontratë me qëllim për të vënë në zbatim koncesionin në përputhje me afatet dhe dispozitat e përcaktuara më poshtë.*

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Përkufizime

- 1.1 **“Kontrata e Koncesionit”** nënkupton marrëveshjen e nënshkruar midis Koncesionerit dhe Autoritetit Kontraktues, duke pranuar kështu kushtet, të drejtat, detyrimet, anekset, dokumentet standarde dhe oferta që do të bashkëlidhen me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj kontrate.
- 1.2 **“Koncesionari”** ose **‘Shoqëria koncesionare’** nënkupton shoqërinë koncesionare Porti MBM (Multy Buoy Mooring) shoqëri e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër unik identifikimi (NUIS) L51621501S.
- 1.3 **“Afati i realizimit të punimeve”** do të thotë data që Punët duhet të përfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve.
- 1.4 **“Preventiv total”** do të thotë volumet e punës të dhëna në projekt të cilat janë orientuese.
- 1.5 **“Defekt”** do të thotë çdo pjesë e Punimeve e papërfunduar në përputhje me kontratën.
- 61.1 **“Objekt i kontratës”** do të thotë të gjitha Punët që koncesionari do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 1.6 **“Palë(t)”** do të thotë nënshkruarit e kontratës.
- 1.7 **“Kantier”** do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 1.8 **“Nënkontraktues”** do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 1.9 **“Kontraktor” (Koncesionari)** do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate/koncesioni dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 1.10 **“Standarde Teknike”** do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 1.11 **“Ngritja e kantierit”** do të thotë punimet e ndërtimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 1.12 **“Personel i koncesionarit”** nënkupton të gjithë punonjësit, agjentët, këshilltarët dhe kontraktorët e Koncesionarit dhe/ose të çdonjërit nga nënkontraktorët.
- 1.13 **“Autoriteti kontraktor”** ose **“Autoriteti”** nënkupton Ministria përgjegjëse për transportin në Republikën e Shqipërisë.

- 1.14 **“Data e hyrjes”** është data që Autoriteti Kontraktor lejon koncesionarin të fillojë punimet në kantier.
- 1.15 **“Data Efektive”** Nënkupton datën në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi, me nënshkrimin e saj nga Palët dhe me miratimin nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
- 1.16 **“Vit financiar i kontratës”** nënkupton një periudhë që fillon në Datën Efektive dhe përfundon në fund të vitit financiar.
- 1.17 **“Vit financiar”** nënkupton një periudhë kohore që fillon cdo vit më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetorin në vijim.
- 1.18 **“Koha e vënies në shfrytëzim”** nënkupton periudhën nga data që Koncesionari, sipas kërkesave të legjislacionit, do të pajiset me lejen/lejet, autorizimin/autorizimet e nevojshme për nisjen e kryerjes së punimeve të ndërtimit, deri në momentin e realizimit të projektit dhe përgatitjen e Koncesionarit për tu pajisur me lejen, autorizimin, miratimin (dokumentin përkatës) lëshuar nga institucioni kompetent për vënien në shfrytëzim të tij si dhe shpalljen e portit, si port i hapur ndërkombëtar.
- 1.19 **“Dokumentimi”** nënkupton përshkrimet e *Shërbimeve* dhe *Niveleve të Shërbimeve*, përcaktime të hollësishme teknike, manual përdorimi, manual operimi, përkufizime dhe procedura të proceseve, dhe cdo dokument tjetër i tillë siç:
- a) është kërkuar të paraqitet nga Koncesionari për Autoritetin bazuar në këtë Kontratë;
  - b) është kërkuar nga Koncesionari me qëllim që të sigurojë Shërbimet;
  - c) ka qënë ose do të krijohet me qëllim sigurimin e Shërbimeve.
- 1.20 **“Informacioni Konfidencial”** nënkupton çfarëdo informacioni, sido që të përçohet, që ka lidhje me çështje biznesi, pune, zhvillime, sekrete tregtare, njohuri, personelin dhe furnitorë të secilës Palë si dhe çdo informacion tjetër që është bërë e qartë që është konfidencial (pavarësisht nëse atij i është vendosur shenja “konfidencial”) ose që do të konsiderohej pa dyshim si konfidencial.
- 1.21 **“Forca madhore”** është çdo situatë që prek përmbushjen nga ana e njëres Palë të detyrimeve të saj që rrjedhin nga aktet, ngjarjet, përjashtimet, ndodhitë përtej kontrollit të arsyeshëm të saj, duke përfshirë pa kufizim aktet e pashpjegueshme, trazirat, luftën apo konfliktet e armatosura, aktet e terrorizmit, zjarret, përmbytjet, stuhitë ose tërmetet apo fatkeqësitë.
- 1.22 **“Ligji i zbatueshëm”** nënkupton çdo ligj të brendshëm apo legjislacion dytësor (dekrete, vendime, urdhra apo udhëzime në nivel qendror apo vendor, të zbatueshëm në fuqi gjatë periudhës së Koncesionit. Ligji i zbatueshëm përfshin, por pa u kufizuar në to, këto akte :
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë- Ligji 7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar.*



*Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë. Ligji Nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;*

*Ligjin Nr.125/2013 “Mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat” të ndryshuar;*

*Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.575, datë 10.07.2013 , “Mbi miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik/privat”*

- 1.23 **“Aneks”** nënkupton çdo dokument që i bashkëlidhet kësaj Kontrate Koncesioni që përbën pjesë integrale të saj.
- 1.24 **“Port”** nënkupton përkufizimin e dhënë nga Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë;
- 1.25 **“Asete të Portit”** ose **“Asete”** do të thotë të çdo dhe të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme e krijuar në përputhje me objektin e kontratës së Koncesionit.
- 1.26 **“Dokumentet Standarde të Tenderit”** do të thotë i gjithë dokumentacioni i shpallur në datë 19.01.2015, në Buletinin zyrtar të Agjencisë së Prokurimit Publik, përkufizimi i DST në ligj.
- 1.27 **“Oferta e Konçesionarit”** ose **“Oferta”** ka kuptimin e parashikuar në Aneksi 3 ‘Plani i Biznesit’ dhe formularin e ofertës.
- 1.28 **“Çmimi i Ofertës”** ka kuptimin siç përcaktohet në Ofertën e Konçesionarit.
- 1.29 **“Punime Ndërtimi”** do të thotë të gjitha punimet që nevojiten për ndërtim;
- 1.30 **“Punime Mirëmbajtjeje”** do të thotë detyrimi i Konçesionarit, sipas kësaj Kontrate, për të kryer punime të tilla që janë të nevojshme për të siguruar mirëmbajtjen dhe funksionimin e duhur të portit dhe të aseteve.
- 1.31 **“Leje, Autorizim, Liçensë”** do të thotë çdo miratim, leje, liçencë, autorizim, aprovim ose certifikatë, nxjerrja ose ripërtëritja e secilës është në përgjegjësinë e çdo Entiteti Shtetëror dhe që kërkohet për zbatimin e kësaj Kontrate.
- 1.32 **“Shërbime”** do të thotë veprimtaria që do të kryhet nga Konçesionari siç përcaktohen në Nenin 25.
- 1.33 **“Tarifë Konçesionare”** do të thotë vlera që Konçesionari i paguan Autoritetit Kontraktues dhe që rregullohet në Nenin 13.
- 1.34 **“Tarifë Shërbimi”** do të thotë tarifat që aplikohen për çdo shërbim të kryer në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrit që mbulon transportet dhe Ministrit që mbulon financat.
- 1.35 **“Vlera e Investimit”** do të thotë shuma totale për kryerjen e investimit sipas ofertës.
- 1.36 **“Xhiro Vjetore”** do të thotë të ardhurat bruto vjetore që grumbullohen nëpërmjet mbledhjes së tarifave nga shërbimet që u ofrohen mjeteve lundruese në përputhje me legjislacionin në fuqi para pagesës së taksave në përputhje me legjislacionin shqiptar apo dhe ushtrimi i cdo aktiviteti tjetër që

- do të ushtrohet në Sipërfaqen e Portit të percaktuar në dokumentat standart DSK.
- 1.37 **“Aktet Korruptive”** do të thotë akti i premtimit, i dhënies, i marrjes ose i marrëveshjes për të marrë para ose ndonjë send tjetër me vlerë, me qëllim korrupsionin ose që perceptohet si korrupsion, për të ndikuar tek një punonjës publik në kryerjen e detyrave të tij shtetërore si dhe aktet që sjellin përgjegjësi penale sipas Kodit Penal Shqiptar.
- 1.38 **“Praktikë e Mirë e Industrisë”** do të thotë praktikat, metodat, standardet, procedurat dhe rekomandimet që janë në përputhje me Ligjet e zbatuara përgjithësisht në ofrimin e Shërbimeve përsa i përket dhënies me koncesion të këtij shërbimi, koncesion i cili pritet në mënyrë të arsyeshme të realizohet nga një kontraktor i aftë dhe me eksperiencë në rrethana të njëjta ose të ngjashme me praktika, metoda, standarde dhe procedura të cilat do të përfshijnë, pa kufizim, standardet shqiptare dhe evropiane (*cilado qofshin më të larta nga një periudhë kohore në tjetrën*). Pa u kufizuar në to, në implementimin apo zbatimin e këtyre standardeve do të përfshihen aktet ligjore e nënligjore shqiptare dhe evropiane si në implementimin apo zbatimin e këtyre standardeve do të përfshihen aktet ligjore e nënligjore shqiptare dhe evropiane.
- 1.39 **“Entitet Shtetëror”** ose **“Entitet”** do të thotë (i) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe/ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike dhe administrative e saj; dhe (ii) çdo gjykatë ose instancë gjyqësore ose çdo entitet tjetër qeveritar, agjenci ose autoritet nën kontrollin e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike e saj, si dhe çdo njësi administrative, që ushtrojnë juridiksion sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë mbi Koncesionarin, ose çdo autoritet i pavarur rregullator, në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 1.40 **“Ligjet”** do të thotë çdo akt ligjor e nënligjor duke përfshirë edhe legjislacionin ndërkombëtar me fuqi detyruese në Republikën e Shqipërisë, që zbatohen për këtë koncesion dhe që rregullon apo ndikon drejtpërsëdrejti apo tërthorazi në këtë Koncesion.
- 1.41 **“Taksë”** do të thotë çdo detyrim financiar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 1.42 **“Periudhë Koncesionare”** do të thotë kohëzgjatja prej 35 vjetësh duke filluar nga Data Efektive, përveç kur Kontrata zgjidhet më parë ose zgjatet në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate.
- 1.43 **“Njoftim për Zgjidhje”** në lidhje me secilën Palë, sipas rastit, do të thotë një njoftim i njërit Palë drejtuar Palës tjetër që deklaron se kjo Kontratë do të zgjidhet, sipas rastit, në vijim: (i) të një Rasti mos përmbushjeje nga Koncesionari ose të një Rasti Mos përmbushjeje nga Autoriteti Kontraktues, i

cili nuk është përmbushur në përputhje me Kontratën, (ii) të Forcës Madhore që zgjat mbi 6 (gjashtë) muaj, ose (iii) të çdo rasti tjetër të parashikuar shprehimisht në këtë Kontratë, i cili do të specifikojë shkakun e zgjidhjes dhe datën e zgjidhjes së saj.

- 1.44 **“Ditë Pune”** do të thotë çdo ditë e javës gjatë së cilës punohet, në kuptim të dispozitave të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.
- 1.45 **“Normë Inflacioni”** do të thotë norma zyrtare e inflacionit sipas përlllogaritjeve të INSTAT-it në momentin kur lind nevoja për referim tek kjo normë.
- 1.46 **“Sigurimi i Kontratës”** do të thotë një sigurim i rradhës së parë dhe pa kushte, i lëshuar nga institucion bankar që vepron në Shqipëri në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që garanton përmbushjen e detyrimeve të Konçesionarit.
- 1.47 **“Njësia e Zbatimit të Projektit Koncesionar”** do të thotë grupi që do të caktohet me urdhër të Ministrit që mbulon transportet për të ndjekur zbatimin e Kontratës me përfaqësues nga ministritë përgjegjëse për transportin, ekonominë, hidrokarburet dhe mjedisin.

## Neni 2

### Interpretime

Në këtë Kontratë, përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe :

- 2.1 Njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas. Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër.
- 2.2 Referimi tek një akt ligjor, dispozitë statutore apo instrument statutor përfshin referim tek ai akt ligjor, dispozitë statutore apo instrument statutor sic është ndryshuar, shtuar apo ri miratuar kohë pas kohe si dhe tek çdo rregullore e nxjerrë në bazë e për zbatim të tij. Pasoja e çfarëdo ndryshimi, shtese apo rimiratimi të tillë mbi këtë Kontratë do të zgjidhet në përputhje me nenet 48-50 të kësaj Kontrate.
- 2.3 Një referim tek secili organ është nëse ai organ:
  - a) zëvendësohet nga një organizëm tjetër, vlerësohet se i referohet asaj organizate dhe
  - b) pushon së ekzistuari, vlerësohet se i referon organizatës që më afër ose në shkallën më të madhe shërben për të njëjtat qëllime ose objekte sikurse ai organ.
- 2.4 Titujt dhe renditja numerike e përdorur për nenet, paragrafët, nen paragrafët, Anekset dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate.

### Neni 3

#### Objekti i koncesionit

- 3.1 Me anën e kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Ligji “Për koncesionet dhe partneritetin publik/privat”, jep me Koncesion të formës BOT (që do të thotë ndërtim, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të Marrëveshje së Koncesionit) të një Porti të llojit MBM (Multi Buoy Mooring), në Porto Romano, Durrës, që të pranojë përpunimin e mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure të madhësive mbi 20.000 ton brenda një kuadri bashkëpunimi reciprok dhe të ngushtë ndërmjet Palëve dhe përcakton tërësinë e të drejtave e detyrimeve të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, si dhe përcakton tërësinë e shërbimeve, detyrimeve që lidhen me ekzekutimin, mbikëqyrjen dhe administrimin e Kontratës së Koncesionit. Koncesionari mund të përpunojë anije që transportojnë hidrokarbure me zhytje mbi 8(tetë) metra.
- 3.2 Forma e Kontratës së Koncesionit është **“ndërtim-shfrytëzim dhe transferim”** në pronësi të shtetit (**Built-Operate-Transfer/ BOT**).
- 3.3 Kontrata e Koncesionit përbëhet nga kjo Kontratë dhe Anekset e saj. Janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate, si anekse të saj, Dokumentet standarte të procedurës konkurruese (dokumentet e tenderit) dhe oferta e koncesionarit. Në rast mospërputhje midis dokumenteve të ndryshme të kësaj Kontrate, mospërputhjet do të zgjidhen sipas kësaj rradhe prioriteti:
  - i. Dokumentat standarte të procedurës koncesionare (dokumentat e tenderit);
  - ii. Oferta e koncesionarit, se bashku me Biznes Planin e paraqitur dhe pranuar;
  - iii. Kjo Kontratë dhe Anekset e saj.
- 3.4 Vendndodhja e objektit të kontratës është në zonën e Porto Romano, Durrës me koordinatat e parashikuara në Aneksin I.

### Neni 4

#### Kërkime dhe Studime

- 4.1 Koncesionari pranon që ka bërë dhe do të bëjë kërkimet dhe studimet e tij për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij bazuar në këtë Kontratë, duke përfshirë kërkimin e këtij informacioni nga Autoriteti Kontraktues, informacioni i cili sipas Koncesionarit kërkohet për një qëllim të tillë.
- 4.2 Koncesionari pranon se është në dijeni të plotë përsa i përket përmbajtjes dhe kërkesave të Autoritetit.
- 4.3 Koncesionari ka të gjithë informacionin, të drejtat, pajisjet, sistemet dhe personelin e nevojshëm dhe të kualifikuar me qëllim që t'i japë mundësi atij të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë, duke përfshirë mundësinë për të përmbushur dhe realizuar Projektin Koncesionar.

- 4.4 Autoriteti garanton se të gjitha të dhënat e tij, të vëna në dispozicion për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat, Koncesionarit, duke përfshirë edhe Dokumentat Standarte të Procedurës Përzgjedhëse Konkurruese janë të sakta, të vërteta dhe pa gabime.

## **DHËNIA DHE DORËZIMI I KONCESIONIT**

### **Neni 5**

#### **Dhënia e koncesionit**

- 5.1 Konform kushteve dhe afateve të parashikuar në këtë Kontratë dhe në Aneksat bashkëlidhur, Autoriteti jep dhe autorizon Koncesionerin të zbatojë projektin koncesionar të formës BOT që do të thotë ndërtim, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë, në përfundim të Marrëveshje së Koncesionit të një Porti të llojit MBM (Multi Buoy Mooring), në Porto Romano, Durrës, si dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Koncesioneri tek Autoriteti Kontraktues.
- 5.2 Në vijim, për përmbushjen e qëllimit të kësaj Kontrate, Koncesioneri do të sigurojë përgatitjen teknike të stafit, ndërtimin dhe operimin sipas standardeve të përcaktuara në Dokumentet Standarde.
- 5.3 Në lidhje me sheshin ku do të kryhen operacionet në tokë, sic përcaktohet në Dokumentat Standarte dhe Aneksin 1 “Pozicioni Gjeografik”, do të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Nr. 8, datë 10.12.2010 “ Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të dhënies të së drejtës subjekteve juridike, për marrjen, në dispozicion, të sipërfaqeve të parashikuara për ndërtimin e objekteve e zhvillimin e veprimtarisë përkatëse në zonën energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës”. Autoriteti do të bëjë përpjekjet e duhura për të asistuar Koncesionarin në këtë procedurë.

### **Neni 6**

#### **Periudha e Koncesionit**

- 6.1 Koncesioni jepet për një periudhë prej 35 vjetësh nga hyrja në fuqi e saj (Data Efektive) dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 35-të të Datës Efektive (Periudha Efektive). Megjithatë, në rastin e një Zgjidhjeje përpara afatit 35 vjeçar, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data Efektive dhe mbaron në Datën e Zgjidhjes.

## Neni 7

### Data Efektive e Kontratës

- 7.1 Data efektive e kësaj kontrate do të jetë data në të cilën do të realizohet nënshkrimi i kësaj Kontrate në mënyrë të rregullt nga të dyja palët, miratimi nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
- 7.2 Në rast se nga Data Efektive Koncesionari nuk fillon përmbushjen e detyrimeve përkatëse kontraktore (aplikimi për leje, licenca të nevojshme) sipas kësaj Kontrate brenda një periudhe prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtën të zgjidhë Kontratën në mënyrë të menjëhershme. Në rast se zgjidhet Kontrata sipas kësaj pike, Palët në këtë Kontrate nuk do të kenë të drejta apo detyrime të mëtejshme.

## Neni 8

### Rastet e zgjatjes së Periudhës së Koncesionit

- 8.1 Në kuptim të këtij neni, afati kohor i kontratës mund të zgjatet, nëse është e nevojshme, për shkak të ndryshimeve të kontratës siç parashikohet në nenet 31, 32 dhe 33 të Ligjit 125/2015 i ndryshuar, por ndryshimi do të realizohet pasi Palët bien dakord me shkrim. Çdo ndryshim do të jetë në formën e një Aneksi dhe do të ndjehet të njëjtën rrugë miratimi si dhe kontrata bazë.
- 8.2 Palët bien dakord që me marrëveshje të ndryshojnë kontratën në lidhje me afatin në rastet kur evidentohen zgjatje e vonesa të shkaktuara jo për faj të Koncesionarit. Në çdo rast koncesionari duhet të provojë që ka ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe procedurale dhe vonesa nuk ka ardhur për arsye subjektive.

## Neni 9

### Autorizime, Leje dhe Licenca

- 9.1 Autoriteti do të bëjë përpjekje për të siguruar që, cdo Ent Shtetëror nën autoritetin e drejtëpërdrejtë të tij, ose jo, që i nënshtrohet marrjes së një njoftim me shkrim nga Koncesionari, do t'i lëshojë Koncesionarit autorizimet, licencat dhe lejet në lidhje me zbatimin e Koncesionit duke nënkuptuar që Koncesionari i ka përmbushur kërkesat për aplikimin e licencave, autorizimeve dhe lejeve të tilla.
- 9.2 Autoriteti do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të siguruar që autorizimet, lejet dhe licencat t'i lëshohen Koncesionarit në përputhje me këtë Kontratë dhe ligjin e aplikuar, pa vonesa të paarsyeshme, sipas një kërkesë të nevojshme të paraqitur nga Koncesionari.

- 9.3 Autoriteti do të bëjë përpjekjet e duhura brenda mundësive dhe kompetencave të tij për të siguruar që të gjitha Entet Shtetërore që ushtrojnë autoritetin e tyre respektiv në lidhje me Koncesionarin, të bashkëpunojnë pa vonesa të paarsyeshme, me Koncesionarin në lidhje me zbatimin e Koncesionit.
- 9.4 Koncesioneri do të marrë dhe ruajë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate të gjitha miratimet, licencat dhe lejet që mund të kërkohen dhe që janë të nevojshme për të mundësuar dhënien e Shërbimit.

## Neni 10

### Dorëzimi i Objektivit dhe Mjediseve të Koncesionit

- 10.1 Në përfundim të Periudhës Koncesionare, Koncesionari do t'i kalojë Autoritetit Kontraktues të drejtën e operimit të portit tip MBM në Porto Romano, Durrës.
- 10.2 Në përfundim të Periudhës Koncesionare, Koncesionari do t'i transferojë pa pagesë Autoritetit Kontraktues pronësinë mbi të gjitha Asetet si dhe në çdo rast, do të kryejë të gjitha ato veprime të cilat janë pazgjdhshëmrisht të lidhura me veprimet e transferimit/kalimit të pronësisë dhe të nënshkruajë të gjitha aktet që do të bëjnë të mundur këtë kalim pronësie.
- 10.3 Procesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara mbarimit të Periudhës Koncesionare pas një inspektimi të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.
- 10.4 Koncesionari do të dorëzojë tek Autoriteti objektin në gjendje të plotë funksionale, sic është parashikuar me marrëveshjen e ndërsjelltë midis palëve.

## Neni 11

### Procedura e Dorëzimit

- 11.1 Në 6 (gjashtë) muajt e fundit të Periudhës Koncesionare, Koncesionari do të fillojë përmbushjen e detyrimeve të dorëzimit, siç jepen më poshtë, do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktues dhe do t'i sigurojë këtij (ose ndonjë pale të tretë të caktuar nëpërmjet saj) të gjithë aksesin dhe informacionin, siç mund të kërkohet ose është e nevojshme për të marrë në ngarkim e shfrytëzimin portit si dhe mbi të gjitha Asetet që i shërbejnë funksionimit normal të portit. Brenda një periudhe kohe të arsyeshme para mbarimit të Periudhës së Koncesionit, Palët do të takohen periodikisht me qëllim që të bien dakord për procedurat e detajuara të dorëzimit, duke përfshirë zërat e caktuar më poshtë.
- a) Menjëherë pas mbarimit të Afatit:
- i. Porti duhet të jetë në një gjendje të arsyeshme mirëmbajtjeje, pastërtie dhe pamjeje, duke marrë parasysh vjetërsinë dhe amortizimin e arsyeshëm, dhe brenda parametrave teknike për një funksionim normal në përputhje me

- destinacionin e tij;
- ii. të Drejtat Koncesionare do të mbarojnë automatikisht dhe pronësia e portit dhe e të gjitha Aseteve do t'i transferohet Autoritet Kontraktues, dhe Konçesionari nuk do të ketë më të drejta t'i përdorë dhe gëzojë ato;
  - iii. të gjithë kostot, pa asnjë përjashtim, në lidhje me mbarimin automatik të të Drejtave Koncesionare, me transferimin e pronësisë së portit dhe të gjitha Aseteve dhe me dorëzimin e tyre siç përcaktohet më sipër, do t'i ngarkohen dhe do të përballohen vetëm nga Konçesionari;
  - iv. Kontratat e licencës për përdorimin e programeve kompjuterike (software) të jenë të vlefshme për të paktën 3 muaj pas përfundimit të periudhës koncesionare dhe të lejojnë përdorimin e tyre nga Autoriteti Kontraktues. Në çdo rast Konçesionari garanton Autoritetin Kontraktues se do të ketë akses të qetë në bazën e të dhënave të mjeteve lundruese;
  - v. Konçesionari do t'i transferojë menjëherë Autoritetit Kontraktues, në masën që ende nuk është transferuar, në çdo rast së bashku me detyrimet përkatëse të lindura gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit duke filluar që nga data e dorëzimit, të gjitha të Drejtat Koncesionare, titujt dhe interesat për portin si dhe të gjitha Asetet dhe gjithshka që përfshihet në to, të lira nga çdo detyrim apo barrë, duke përfshirë:
    1. të gjitha lëndët e para, pjesët e konsumueshme dhe pjesët e këmbimit,
    2. të gjithë pronën e trupëzuar;
    3. të drejtat e pronësisë intelektuale që mbaheshin nga Konçesionari ose Shoqëria Koncesionare (ato që burojnë nga pronësia, nga ndonjë licencë ose nga ndonjë burim tjetër), në masën që këto kërkohen në mënyrë të arsyeshme për shfrytëzimin e portit dhe të gjitha Aseteve;
    4. Konçesionari duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
    5. Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, koncesionari duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.
    6. të gjitha ndërtimet dhe pjesët e lidhura pazgjydhmërisht me to;
    7. librat apo dokumentet e evidencave (records) të kompjuterizuara ose jo, raportet, të dhënat, dosjet dhe informacioni, vizatimet, rezultatet e testeve, dokumentet,



8. të gjitha garancitë e pajisjeve elektromekanike dhe kompjuterike, materialeve dhe punimeve,
  9. të gjitha të drejtat kontraktore, duke përfshirë qiratë dhe policat e sigurimit,
  10. të gjitha punimet në proces (duke përfshirë Punimet e Ndërtimit, nëse ka) në bazë të kontratave me shitës, furnizues, kontraktorë dhe nënkontraktorë,
  11. kontratat e liçensës për përdorimin e programeve kompjuterike, të cilat duhet të parashikojnë zëvendësimin e Konçesionarit nga Autoriteti Kontraktues, në masën që këto kërkohen në mënyrë të arsyeshme për shfrytëzimin e portit dhe e Pajisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike; dhe
  12. të gjitha të drejtat në lidhje me çdo shumë sigurimi për t'u paguar në emër dhe për llogari të Konçesionarit, por e papaguar në datën e zgjidhjes së kësaj Kontrate, në lidhje me të drejtat, titujt dhe interesat e Konçesionarit në Projekt Koncesionar;
- vi. Kontratat e punës mes punëmarrësve dhe Shoqërisë Koncesionare do të jenë për një periudhë kohe me afat prej jo më shumë se tre muaj pas përfundimit të periudhës koncesionare. Koncesionari njeh detyrimin t'i bëjë të ditur çdo punëmarrësi këtë fakt në kontratën individuale të punës.
- vii. Koncesionari do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të zbatuar çdo transferim të parashikuar në këtë Nen, duke përfshirë nënshkrimin e çdo dokumenti të kërkuar, si dhe lidhjen me Autoritetin Kontraktues të çdo akti, kontrate ose marrëveshjeje të nevojshme dhe pa asnjë kosto ose shpenzim për Autoritetin Kontraktues (përveçse rastit siç parashikohet shprehimisht në nënparagrafin (viii) më poshtë); dhe
- viii. Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës për pajisjen ose dhënien, me shpenzimet e tij, të të gjitha Autorizimeve për të shfrytëzuar portin dhe per Asetet (ose për të transferuar shfrytëzimin e tyre tek një palë e tretë), si dhe Konçesionari do të ndihmojë Autoritetin Kontraktues për identifikimin dhe marrjen e çdo Autorizimi të tillë, duke përfshirë dhënien e ndihmës së arsyeshme në përgatitjen e kërkesave në lidhje me to.
- b) Në rast zgjidhje para Afatit të kësaj Kontrate, kërkesat e pikës (a) të këtij Neni do të zbatohen *mutatis mutandis* edhe për këto raste.
- c) Autoriteti Kontraktues bie dakord dhe merr përsipër që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga transferimi i të drejtave dhe titujve në lidhje me asetet dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse siç është parashikuar në paragrafët më lart, ai do të lëshojë Certifikatën e Pranimit të Dorëzimit të Portit. Koncesionari duhet të dorëzojë këto asete në gjendje funksionale.

## **MASAT FINANCIARE**

### **Neni 12**

#### **Të ardhurat e Koncesionarit**

- 12.1 Të ardhurat e Koncesionarit do të përbëhen nga pagesat e përfituara nga shërbimet e ofruara në përputhje me objektin e këtij koncesioni.

### **Neni 13**

#### **Tarifa e koncesionit**

- 13.1 Koncesionari detyrohet t'i paguajë Autoritetit Kontraktues një Tarifë Koncesioni të barabartë më 2% (dy përqind) të Xhiros Vjetore (para tatim fitimit) që Koncesionari do të grumbullojë nga Tarifatat e aplikuara (duke përjashtuar TVSH-në), bazuar në deklaratimet financiare të kontrolluara të Shoqërisë Koncesionare për çdo Vit Financiar.
- 13.2 Detyrimi i Koncesionarit për pagesën e Tarifës së Koncesionit, fillon pas Vënies në Shfrytëzim dhe paguhet me këste mujore brenda datës 15 (pesëmbëdhjetë) të muajit pasardhës.
- 13.3 Me mbylljen e vitit financiar dhe certifikimin e bilancit Palët do të bëjnë rakordimet lidhur me Tarifën Koncesionare.
- 13.4 Tarifa e koncesionit do të paguhet brenda datës 15 të cdo muaji, bazuar në deklaratimin mujor sipas legjislacionit fiskal në fuqi nga Koncesioneri. Palët bien dakord se në përfundim të cdo Viti Financiar do të rakordojnë shifrat financiare për të shmangur cdo pagesë të shtuar apo të munguar të kësaj Tarife.

### **Neni 14**

#### **Tarifatat e aplikuara**

- 14.1 Tarifatat për shërbimet e portit do të aplikohen pas përfundimit të Fazës Ndërtimore dhe Vënies në Shfrytëzim të Portit. Për tarifatat e tjera të papërcaktuara në ofertën teknike, ligjore dhe ekonomike, do të aplikohen dispozitat e Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë në fuqi.
- 14.2 Tarifatat do të rishikohen, çdo vit bazuar në Normën e Inflacionit të publikuar nga institucioni përgjegjës për publikimin e normës së inflacionit. Do të merret për bazë Norma e Inflacionit e deklaruar në baza vjetore në varësi të Datës Efektive.

## Neni 15

### Financimi i Koncesionit

- 15.1 Koncesionari me qëllim përmbushjen e detyrimeve të marra për realizimin e kësaj kontrate koncesionare ka të drejtë të kërkojë financime me kredi në institucione financiare për të cilën do të njoftojë Autoritetin Kontraktor.
- 15.2 Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate Koncesioni. Përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Koncesionari.
- 15.3 Autoriteti nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt institucioneve financiare, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

## Neni 16

### Vlera e investimit dhe riinvestimit

- 16.1 Vlera që Koncesionari do të investojë në këtë Koncesion është 10.200.000 (dhjetë milionedyqindmije) dollarë, referuar ofertës së dhënë nga Koncesionari, si më poshtë:
  - i. Studim dhe Faza përgatitore e Terrenit me vlerë prej 2,756,000 USD;
  - ii. Faza Ndërtim/Zhvillim (materiale dhe pajisje; mjete dhe makineri; kosto pune) me vlerë prej 7,138,000 USD;
  - iii. Faza Ndërtim/Zhvillim me vlerë prej 306,000 USD.
- 16.2 Duke filluar nga viti i 5-të para përfundimit të afatit të kësaj kontrate, Koncesioneri do të riinvestojë 40% të vlerës së investimit në përputhje me ofertën e koncesionarit. Norma e ri investimit do të sigurojë që porti të jetë gjithnjë në funksionim të mirë. Kjo vlerë është kusht i pa-negociueshëm i Kontratës dhe nuk mund të ndryshohet në rast të Ndryshimit të Kontratës. Në rast se 4 (katër) muaj para përfundimit të Periudhës Koncesionare Koncesionari nuk ka kryer plotësisht apo pjesërisht riinvestimin detyrohet t'i paguaje Autoritetit Kontraktues diferencën e Vlerës së Riinvestimit të pakryer jo më vonë se dita e fundit të Periudhës Koncesionare.
- 16.3 Në rast mos përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 16.2, koncesionari detyrohet të paguajë penaltetet 10.000 (dhjetë mijë) lek në ditë.
- 16.4 Pavarësisht nga penalteti i mësipërm koncesionari nuk do të zhvishet nga përgjegjësia për të përmbushur këtë detyrim.

## **Neni 17**

### **Kontrollet**

- 17.1 Brenda Periudhës së Koncesionit Autoriteti Kontraktues do të kontrollojë dhe monitorojë periodikisht dhe vazhdimisht Konçesionarin lidhur me zbatimin e kushteve të Konçesionit në formën që do ta gjykojë të përshtatshme dhe të arsyeshme.
- 17.2 Konçesionari është i detyruar t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues një raport të përvitshëm, jo më vonë se 3 (tre) muaj nga përfundimi i çdo viti kalendarik, lidhur me parametrat kyç të Konçesionit dhe mënyrën se si po e zbaton atë.
- 17.3 Konçesionari është i detyruar t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor raporte tre mujore lidhur me parametrat kyç të operimit të Konçesionit si dhe informacione shtesë të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.
- 17.4 Konçesionari, është i detyruar të marrë pjesë në një mbledhje të përvitshme me Autoriteti Kontraktues me qëllim kontrollin e efektshmërisë së Konçesionarit gjatë Periudhës Koncesionare të tij.
- 17.5 Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë që të jetë i pranishëm ose të vëzhgojë metodat dhe inspektimet e kontrollit të cilësisë për të konfirmuar se çdo Sherbim përputhet me kërkesat e kësaj Kontrate. Konçesionari do të ndihmojë në kryerjen e këtyre kontrolleve. Nëse Shërbimi nuk arrin të jetë në përputhje me ndonjë aspekt thelbësor të kërkesave të kësaj Kontrate (duke përfshirë kërkesat për cilësinë ose sigurinë), Autoriteti Kontraktues mund ta njoftojë Konçesionarin për këtë mospërbushje. Konçesionari do ta bëjë korrigjimet e nevojshme brenda 10(dhjetë) ditë pune nga njoftimi i Autoritetit Kontraktues.
- 17.6 Pa cënuar dispozita të tjera të kësaj Kontrate, Koncesionari njeh dhe pranon të gjitha kontrollet që bëhen nga çdo dhe të gjitha entet shtetërore që janë organe përgjegjëse sipas Ligjit për këto kontrolle. Koncesionari është i detyruar që t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues të gjitha raportet, aktet dhe certifikatat e lëshuara për punimet e ndërtimit nga entet shtetërore.

## **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE**

### **Neni 18**

#### **Detyrimet e Autoritetit Kontraktues**

- 18.1 Autoriteti Kontraktues merr përsipër të sigurojë vazhdimësinë e Kontratës për sa është e mundur, pavarësisht ndryshimeve të objektivave strategjik kombëtare dhe të sektorit.
- 18.2 Autoriteti Kontraktues, përveç detyrimeve të parashikuara në nenin 18, do të marrë masat e duhura për të asistuar Koncesionarin në marrëdhënie me institucionet publike, për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.

- 18.3 Autoriteti, nuk do të lidhë dhe/ose deklarojë të lidhur çfarëdolloj kontrate apo marrveshje me palë të treta të cilat mund të japin ose të deklarojnë të drejtat e identifikuar në nenet e parashikuara në këtë kontratë, një pale të tretë.
- 18.4 Në qoftë se Autoriteti me veprime ose mosveprime nuk përmbush detyrimet e mësipërme dhe si rezultat i kësaj mospërmbushje Koncesioneri pëson dëme pasurore, në vënien në shfrytëzim të projektit, atëherë ky i fundit ka të drejtë të kërkoj shlyerjen e dëmeve të shkaktuara.

## **Neni 19**

### **Plani i Projektit**

- 19.1 Koncesionari do të sigurojë që projekti do të jetë në përputhje me dokumentat standarte dhe ofertën e paraqitur prej tij.

## **Neni 20**

### **Programimi i punimeve**

- 20.1 Koncesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit menjëherë pas sigurimit të të gjithë lejeve të nevojshme për fillimin e punimeve. Koncesionari merr përsipër se porti do të bëhet i gatshëm për shfrytëzim brenda një periudhe kohore prej 18 muajsh nga data e fillimit të punimeve.
- 20.2 Koncesionari merr përsipër se do të vendosë në dispozicion të autoritetit kontraktues brenda 3 muajve nga përfundimi i punimeve, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për ta shpallur portin si port i hapur për trafik ndërkombëtar në zbatim të legjislacionit në fuqi.

## **Neni 21**

### **Vonesat në zbatim**

- 21.1 Nëse, në çdo kohë, Koncesionari është në gjëndje të parashikojë se ai nuk do të arrijë ose ka pak të ngjarë që të arrij cilindo nga afatet e parashikuara në Aneksin 2 'Plani i Projektit', ai do të njoftojë menjëherë Autoritetin mbi faktin e Vonesës duke bërë një përmbledhje të shpjegimeve përkatëse.
- 21.2 Koncesionari, sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë sesa 10 (dhjetë) ditë pune pas njoftimit fillestar sipas paragrafit të mësipërm, do t'i japë Autoritetit hollësi të plota me shkrim për:
- a) arsyet e vonesës;
  - b) pasojat e vonesës;
  - c) nëse Koncesionari pretendon se vonesa vjen për shkak të Autoritetit duhet të paraqesi edhe arsyen e këtij pretendimi.

- 21.3 Koncesionari është i detyruar të respektoj këtë procedurë, me përjashtim të një situatë emergjente/force madhore kur ai për të shmangur efektet negative të vonesës nuk ka kohë të mjaftueshme për të njoftuar Autoritetin në zbatim të pikave të mësipërme.

## Neni 22

### Zgjidhja e pasojave të vonesës

- 22.1 Cfarëdo konflikti në lidhje me apo si rrjedhojë e vonesave do të zgjidhet përmes procedurës për Zgjidhjen e Mosmarrveshjeve të parashikuar në nenin 53 të kësaj Kontrate. Gjatë kohës së konfliktit të dyja palët do të vazhdojnë të bashkëpunojnë për të zgjidhur shkaqet apo për të zvogëluar pasojat.
- 22.2 Në rast se është e mundur, Koncesionari do të paraqesë një projekt të Planit të Korrigjimit, në rast se nuk është në gjendje të arrijë afatet e parashikuara sipas Aneksit 2. Projekt Planit Korrigjimit do të identifikojë çështjet që rrjedhin nga vonesa dhe hapat që Koncesionari propozon që të ndërmerren për të arritur afatet në përputhje me këtë Kontratë.
- 22.3 Projekt Planit i Korrigjimit do t'i paraqitet Autoritetit për miratim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në cdo rast jo më vonë se 20 ditë pune pas njoftimit fillestar. Autoriteti nuk mund të refuzoj në mënyrë të paarsyeshme, miratimin e tij për një Projekt Plan Korrigjimi.
- 22.4 Koncesionari do të veprojë në përputhje me Planin e tij të Korrigjimit në vijim të miratimit të tij nga Autoriteti.

## Neni 23

### Vonesat në arritjen e Planit të Projektit për shkak të Autoritetit

- 23.1 Nëse Koncesionari nuk i ka arritur afatet e parashikuara nga palët në 'Planin e Projektit' si rezultat i një shkakut të Autoritetit, atëherë pasi Koncesionari të ketë njoftuar paraprakisht me shkrim Autoritetin mbi shkakun e vonesës, ai do të përfitojë nga të drejtat dhe lehtësirat e parashikuara në këtë nen si:
- Sipas paragrafit të mëposhtëm do ti lejohet një shtrirje e afatit e barabartë me Vonesën e shkaktuar për shkak të Autoritetit;
  - Mosarritja për të respektuar afatet e parashikuara në 'Planit të Projektit', Aneksi 2, nuk do të quhet shkelje e kësaj Kontrate;
  - Nuk do të ketë përgjegjësi për pagimin e penaliteteve, në lidhje me mosarritjen e afateve në masën që vonesa vjen drejtëpërdrejtë nga shkakut i Autoritetit;
- 23.2 Në një rast të tillë Autoriteti duhet të:

- marrë në konsideratë kohëzgjatjen e vonesës, natyrën e pazotësisë së Autoritetit dhe pasojën e vonesës si edhe të pazotësisë të Autoritetit mbi aftësinë e Koncesionarit për të vepruar në përputhje me Planin e Projektit;
  - këshillohet me Përfaqësuesin e Koncesionarit në përcaktimin e pasojës së vonesës dhe në atë se si të pakësohen pasoja të tilla atje ku kjo mund të praktikohet në mënyrë të arsyeshme;
  - caktoj një Datë të Rishikuar të Afateve; dhe (nëse është e përshtatshme) , të bëjë cdo rishikim vijues ndaj afateve vijuese në Planin e Projektit.
- 23.3 Autoriteti nuk do të vonohet paarsyeshmërisht kur të marrë në shqyrtim dhe kur të përcaktojë pasojën e një vonese sipas këtij neni ose në rënien dakord për një Ndryshim sipas Proçedurës së Ndryshimit të Kontratës. Në të gjitha rastet ky afat nuk mund të kalojë periudhën kohore prej 45 ditësh pune.

## Neni 24

### Monitorimi dhe Mbikqyrja

- 24.1 Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë sa herë ta gjykojë të arsyeshme, gjatë gjithë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj. Autoritetit Kontraktues, ka të drejtë të ushtroj një mbikqyrje të përgjithshme me afate tremujore, gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë ecurinë e punimeve, cilësinë dhe përshtatshmëria të jetë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.
- 24.2 Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë mbikqyrjes së përgjithshme, Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

## Neni 25

### Shërbimet

- 25.1 Koncesioneri do të sigurojë që projekti të jetë në përputhje me të gjitha aspektet e Kërkesave të Autoritetit, këtë Kontratë dhe Anekset e parashikuara në këtë kontratë.
- 25.2 Koncesioneri do të zbatoj projektin dhe do të ofrojë shërbimet e tij në përputhje me:
- Politikën e Sigurisë;
  - Planet e Cilësisë;
  - Standartet e parashikuara në dokumentat standarte;

- Nivelin e aftësive profesionale, kujdesit, planifikimit, mbikqyrjes, kontrollit dhe gjykimit të cilat mund të priten nga një shoqëri profesioniste me përvojë në dhënien e shërbimeve të tipit dhe kompleksitetit të kërkuar nga Autoriteti sipas kësaj Kontrate.

## **Neni 26**

### **Zgjidhja e konflikteve për shërbimet**

- 26.1 Çdo konflikt që lind si rezultat i pazotësisë së koncesionarit për sigurimin e Shërbimeve në pajtim me Nivelet e Shërbimit dhe/ose këtë Kontratë do të zgjidhet përmes Procedurës së Zgjidhjeve të Konflikteve. Në pritje të zgjidhjeve të konflikteve të dyja palët do të vazhdojnë të zgjidhin çështjet dhe të zbusin efektet e këtij dështimi.

## **Neni 27**

### **Përmirësimi i shërbimeve**

- 27.1 Koncesionari ka të drejtë që gjatë gjithë kohës të identifikojë përmirësime të reja ose potenciale të Shërbimeve në pajtim me këtë Nen. Në këtë kuadër Koncesionari, ka të drejtë të identifikojë dhe raportojë pranë autoritetit, për:
- Nevojën e teknologjive përkatëse të reja dhe të zhvilluara, të cilat mund të përmirësojnë sistemin dhe/ose Shërbimet, dhe këto teknologji të zhvilluara potencialisht të mundshme për Koncesionarin dhe Autoritetin, të cilat Palët duan të adoptojnë;
  - Përmirësime të reja ose të mundshme të shërbimeve duke përfshirë cilësinë, përgjegjshmërinë, procedurat, si mekanizmat e performancës dhe shërbimet mbështetëse të klientit në lidhje me Shërbimet.
- 27.2 Në çdo rast Koncesionari duhet të marrë miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 28**

- 28.1 Koncesionari do të sigurojë që informacioni që do ti jepet Autoritetit të jetë i mjaftueshëm për Autoritetin. Koncesionari do të jap cdo informacion të mëtejshëm që Autoritetit kërkon.
- 28.2 Nëse Autoriteti dëshiron të përfshijë ndonjë përmirësim të identifikuar nga Koncesionari, Autoritetit do ti dërgojë Koncesionerit një kërkesë ndryshimi dhe palët do të zhvillojnë një plan për zbatimin e përmirësimeve brenda një afati 20 (njëzet) ditë pune. Koncesionari do të zbatojë përmirësimin në përputhje me parashikimet e planit të zbatimit, i miratuar nga Autoriteti.



## **Neni 29**

### **Rregjistra dhe Raporte**

- 29.1 Palët do të veprojnë në përputhje me kërkesat e Autoritetit lidhur me mbajtjen e të dhënave dhe bërjen e raporteve. Koncesionari do të sigurojë të dhëna Autoritetit mbi një bazë të rregullt sic do të përcaktohet me hollësi nga Autoriteti.

## **Neni 30**

### **Kontrolli i ndryshimit të Kontratës**

- 30.1 Çdo kërkesë për Ndryshim do të nënshtrohet Procedurës së Kontrollit të Ndryshimit të Kontratës.
- 30.2 Në rast se një akt i ri ligjor, ndryshim apo amendim i legjislacionit Shqiptar apo i akteve nënligjore, ka si pasojë zbatimin ndaj Koncesionarit të detyrimeve të reja apo më të larta të taksave, tatimeve, tarifave, pagesave, apo cfarëdolloj detyrimi tjetër, ndryshe nga detyrimet e Koncesionarit të parashikuara në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, Palët bien dakord të ndryshojnë Kontratën në mënyrë që të shmangët impakti financiar negativ për të ruajtur rentabilitetin financiar të projektit koncesionar sikur ky ndryshim ligjor të mos kishte ndodhur duke përjashtuar ndryshime të tilla të cilat ndikojnë në të gjitha bizneset në Shqipëri. Në çdo rast rishikimi i kushteve duhet të synojë vazhdimësinë e kontratës dhe krijimin e lehtësirave të nevojshme për zbatimin e këtij projekti koncesionar.

## **Neni 31**

### **Personeli**

- 31.1 Koncesionari do të sigurojë që ai do të ketë personel të mjaftueshëm në mënyrë që të plotësojë kërkesat e përcaktuara në këtë Kontratë.
- 31.2 Koncesionari do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të siguruar vazhdimësinë e personelit dhe për të siguruar që shkalla e ndërrimit të personelit kryesor të përfshirë në sigurimin ose menaxhimin e shërbimeve është së paku po aq e mirë sa edhe standartet e industrisë për një koncesionar që është duke operuar me Praktikën e Industrisë së Mirë, në zona dhe rrethana të njejta.
- 31.3 Koncesionari pranon që personeli kryesor është i rëndësishëm dhe themelor për funksionimin dhe mbarvajtjen e objektit të koncesionit. Koncesionari do të sigurojë që çdo zëvendësim do të jetë i kualifikuar dhe me përvojën e përshtatshme dhe tërësisht kompetent për të zbatuar detyrat e caktuara të Personelit Kyc të cilin ai ose ajo ka zëvendësuar.



ndotjeve dhe të përdorimit të lëndëve kimike për pastrimin e ndotjeve në rastet e derdhjes së karburanteve në det.

- k) Porti duhet të ketë një plan emergjence të miratuar për reagimin ndaj ndotjes detare, si edhe pajisje të nevojshme reaguese ndaj ndotjes në zbatim të këtij plani. Gjithashtu Koncesionari duhet t'u kërkojë anijeve që të kenë, pajisje reaguese të nevojshme;
- l) Të ndërtojë Portin sipas standarteve BS/DIN (British standards/Deutch standards) dhe standartet e tjera analoge;
- m) Ndërtimin e Portit nëpërmjet një teknologjie bashkëkohore të certifikuar teknikisht nga institucionet përkatëse për parandalimin e çdo impakti mjedisor, të mbrojtjes nga zjarri ose ngjarje të jashtëzakonshme, duke siguruar parametra bashkëkohore e për funksionimin e tij duke qene i shoqëruar me materialin studimor për ndikimin në mjedis të këtyre punimeve;
- n) Të parandalojë dhe kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij dhe të kthejë ambientin, me shpenzimet e veta, në situatën e mëparshme (para ndotjes);
- o) Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
- p) Të sigurojë maksimumi brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve apo në momentin e pajisjes me leje ndërtimi nëse ky ndodh para afatit në fjalë, të gjithë burimet e nevojshme financiare apo të çdo lloji dhe natyre tjetër të kërkuara për përmbushjen e Kontratës;
- q) Të njoftojë Autoritetin Kontraktues, brenda 7 (shtatë) ditëve, për çdo ndryshim thelbësor në burimet e financimit duke i paraqitur në të njëjtën kohë Autoritetit Kontraktues dokumenta provues dhe propozime se si do të zgjidhet situata financiare;
- r) Të punësojë/kontrakttojë persona të aftë profesionalisht për ofrimin e Shërbimeve, në përputhje me Ligjet, Kontratën dhe Praktikën e Mira të Industrisë;
- s) Të marrë masat për të garantuar sigurinë në territorin ku do të ushtrojë aktivitetin dhe do të ofrojë Shërbimet;
- t) Të lejojë Autoritetin Kontraktues të monitorojë dhe kontrollojë përmbushjen e Kontratës;
- u) Të përmbushë, me shpenzimet e kostot e veta çdo punim shtesë që mund të jetë i nevojshëm për të korrigjuar defektet apo mangësitë e konstatuara nga Autoriteti Kontraktues dhe do të sigurojë përfundimin në kohë të Projektit/Infrastrukturës dhe Shërbimeve të Projektit sipas parashikimeve të kësaj Kontrate;

- v) Të zbatojë Ligjet gjatë veprimtarisë së tij, duke përfshirë por pa u kufizuar në legjislacionin mjedisor lidhur me ndotjen e ajrit, tokës, emetimin e zhurmave, etj., Kodin e Punës dhe rregulloret e sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjenës dhe të sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo aksident, fatkeqësi apo dëm në punë;
- w) Të përballojë vetë të gjitha kostot apo shpenzimet e nevojshme për riparime apo zëvendësime të pajisjeve që përdoren për përmbushjen e Kontratës;
- x) Konçesionari duhet që gjatë Periudhës së Koncesionit të paguajë në mënyrë të rregullt të gjitha Tarifën Konçesionare, taksat, tatimet, detyrimet, T.V.SH-në, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të të punësuarve, borxhet apo tatimin mbi të ardhurat, detyrimet për taksat indirekte, detyrimet doganore, taksat e shërbimeve të cilat mund të vilen, të merren ose të përfitohen në çdo kohë nga çdo Ent apo Organ Shtetëror duke përfshirë, në zbatim të Infrastrukturës dhe Shërbimeve të Projektit sipas ligjit në fuqi;
- y) Të përballojë vetë të gjitha shpenzimet apo kostot që lidhen me shpërblime dëmsh që eventualisht mund t'i shkaktohen palëve të treta;
- z) Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra si dhe shpenzimet noteriale.
- aa) Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për te vepruar konform legjislacionit në fuqi. Konçesionari duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

## Neni 34

### Detyrime të Posaçme të Koncesionarit

#### 34.1 Koncesionari është i detyruar:

- a) Të siguroj cilësi të lartë, besueshmëri dhe qëndrueshmëri të Shërbimeve gjatë periudhës së Koncesionit;
- b) Të informojë Autoritetin për çfarëdo rrethane që mund të dëmtojë procesin e zbatimit të Koncesionit;
- c) Të zbatojë teknologji të përshtatshme për ndërtimin, shfrytëzimin e një porti të llojit MBM;
- d) Të raportojë në përputhje me nenin 17 tek Autoriteti në lidhje me përparimin e realizuar në zhvillimin e Koncesionit, sic përcaktohet në këtë Kontratë;

- e) Të marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme me qëllim garantimin e kushteve të sigurisë në punë për punonjësit e tij si dhe të zbatojë legjislacionin që lidhet me parandalimin e dëmeve dhe fatkeqësive;
- f) Të marrë masa për të garantuar mbrojtjen e mjedisit gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

### **Neni 35** **Forca Madhore**

35.1 “Rast i Forcës Madhore” do të thotë çdo rrethanë që nuk është në mënyrë të arsyeshme në kontroll, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të Palës së Cenuar (“Pala e Cenuar”) që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të Palës së Cenuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

- a) kjo rrethanë, pavarësisht ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm, nuk mund të parandalohet ose nuk ishte e mundur të parandalohet, shmangej ose mënjanohej nga Pala e Cenuar;
- b) Pala e Cenuar mori ose ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në aftësinë e Palës së Cenuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për të zbutur pasojat e saj;
- c) ngjarja nuk është, ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cenuar të një prej detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe
- d) Pala e Cenuar t’i ketë dhënë njoftim Palës tjetër (“Palës së Pacenuar”).

35.2 Rastet e Forcës Madhore përfshijnë rrethanat e mëposhtme, me kusht që ato të plotësojnë kriteret e shprehura në përkufizimin e Rastit të Forcës Madhore më sipër:

- a) veprimet e luftës, pushtimi ose akti i një armiku të jashtëm, ose aktet e terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimit;
- b) aktet e rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat e natyrës politike, aktet ose fushatat e terrorizimit;
- c) rrufeja, zjarri, tërmeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore;
- d) epidemia ose murtaja; dhe
- e) çdo akt sabotimi, grevat ose veprimtaritë e punës për të imponuar ose për të ngadalësuar punën (sidoqoftë duke përjashtuar punonjësit e Palës që e

pretendon atë si Rast të Forcës Madhore ose punonjësit e ndonjë prej aksionarëve të kësaj Pale, ose punonjësit e ndonjë filiali të kontrolluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga shoqëria mëmë ose degë e ndonjë aksionari të kësaj Pale).

35.3 Pala e Cenuar do të përjashtohet nga përmbushja e detyrimeve, dhe nuk do të quhet se është në mos përmbushje në lidhje Marrëveshjen e Konçesionit për aq kohë, dhe në atë masë, sa pamundësia për të përmbushur detyrimet të varet nga Ngjarja e Forcës Madhore, si dhe Afati do të shtyhet automatikisht për aq sa do të zgjasë Ngjarja e Forcës Madhore.

35.4 Pasojat e Rasteve të Forcës Madhore Pavarësisht nga detyrimet për mirëmbajtje të Konçesionarit, siç detajohen në nenin përkatës (“Dhënia e të Drejtave Konçesionare”), rastet e mëposhtme do të zbatohen në masën që Konçesionari është Palë e Cenuar në një Rast të Forcës Madhore:

- a) Rastet e Forcës Madhore të Siguruara;
- b) Në masën që Pasojat e një Rasti të Forcës Madhore janë brenda kushteve që mbulohen nga garancitë siguroese që kërkohet të bëhet e të mbahet sipas Nenit 41 Sigurimi, Konçesionari do të ngrejë pretendime e bazojë ato drejtpërdrejt tek ky Nen dhe do të zbatojë procedimet përkatëse.

### **Neni 36**

#### **Pasojat e Ngjarjeve të Forcës Madhore**

36.1 Në rastet e forcës Madhore, Pala e Cënuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 15 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyerjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

### **Neni 37**

37.1 Në rastin e ndodhjes së çfarëdo Ngjarje të Forcës Madhore, do të zbatohen sa vijon:

- a) Nuk do të ketë asnjë përfundim të kësaj Kontrate përveçse kur parashikohet në nenet në vijim.
- b) Në rastin kur një Ngjarje e Forcës Madhore ndodh përpara Datës Efektive, afati për arritjen e Datës Efektive do të shtrihet në periudhën e barabartë me kohëzgjatjen e ciklit të nevojshëm për korrigjimin e dëmtimeve të shkaktuara nga Ngjarja e Forcës Madhore;
- c) Në rastin kur një Ngjarje e Forcës Madhore ndodh pas Datës Efektive, Periudha e Koncesionit do të zgjatet për kohëzgjatjen e ciklit të

nevojshëm për korrigjimin e dëmtimeve të shkaktuara nga Ngjarjeja e Forcës Madhore; sipas një marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve.

### **Neni 38**

- 38.1 Autoriteti do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme brenda kompetencave të tij për të garantuar Koncesionarin nga ndonjë dhe çdo lloj procedimi, veprimi, pretendimi të palës së tretë për humbje, dëm dhe shpenzim të cfarëdo lloji dhe natyre që lind nga shkelja nga ana e Autoritetit, zyrtarëve, nëpunësve dhe agentëve të tij, të ndonjë detyrimi të Autoritetit sipas kësaj Kontrate, përveç se në shkallën që një pretendim i tillë ka lindur për shkak të shkeljes nga Koncesioneri të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.
- 38.2 Koncesionari do të dëmshpërblejë dhe do të vazhdojë të dëmshpërblejë Autoritetin gjatë Periudhës së Koncesionit nga dhe kundër ndonjë dhe çdo procedimi, veprimi, pretendimi të palës së tretë për humbje, dëm dhe shpenzim të cfarëdo lloji dhe natyre që lind nga shkelja nga ana e Koncesionerit sipas kësaj Kontrate, përveçse në shkallën që kjo humbje ose ky dëm lind nga shkelja e ndonjë dispozite të shprehur të kësaj Kontrate nga Autoriteti ose ndonjë Organ Shtetëror ose ndonjë veprim ose mosveprim i qëllimshëm i autoritetit ose i ndonjë Organi Shtetëror;
- 38.3 Pala që shkakton një shkelje të kësaj Kontrate do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të pakësuar humbjen dhe dëmin.

### **Neni 39**

#### **Konfidencialiteti**

- 39.1 Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjese të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.
- 39.2 Paragrafi i mësipërm nuk do të zbatohet në shkallën që:
- a) Ky informacion ka qënë në zotërim të Palës që bën zbulimin pa detyrimin e konfidencialitetit para zbulimit të tij nga zotëruesi i informacionit;
  - b) Ky informacion ishte përftuar nga një palë e tretë pa detyrimin e konfidencialitetit;
  - c) Ky informacion ka qënë për përdorim publik në kohën e zbulimit ndryshe nga shkelja e kësaj Kontrate; ose
  - d) Një informacion i tillë është i detyrueshëm për tu nxjerrë sipas ligjit.
- 39.3 Asgjë në këtë Kontratë nuk do e pengojë Autoritetin të zbulojë nga Informacioni Konfidencial i Koncesionerit:

- a) Ndaj cilitdo entë qeveritar. Të gjitha entet qeveritare që marrin këtë Informacion Konfidencial do të kenë të drejtë t'ja japin më tej Informacionin Konfidencial departamenteve të tjera qeveritare, mbi bazën që informacioni të jetë konfidencial dhe të mos i zbulohet një palë të që nuk është pjesë e departamentit qeveritar ose e një Autoriteti.
- b) Mbi bazën e 'nevojës për njohuri' nga konsulenti, kontraktori ose ndonjë person tjetër të angazhuar nga Autoriteti me kusht që një person i tillë të bjerë dakord që ta ruajë këtë informacion di konfidencial.

#### **Neni 40**

##### **Kufizimet në Përgjegjesi**

- 40.1 Koncesionari nuk e kufizon përgjegjësinë e tij për:
- a) Vdekjen ose plagosjen personale të shkaktuar nga neglizhenca e tij ose nga neglizhenca e punonjësve, agjentëve ose nënkontraktorëve të tij; ose
  - b) Mashtrimin nga ana e tij ose nga punonjësit e tij ne lidhje me, dhe ne zbatim të detyrimeve të marra persiper në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.

#### **Neni 41**

##### **Sigurimi i asetëve**

- 41.1 Gjatë gjithë Kohëzgjatjes së Kontratës, me qëllim garantimin e një aktiviteti të pandërprerë Koncesionari duhet të bëjë sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, asetëve ekzistuese dhe të krijuara sipas vlerës kontabile të pasqyruar në bilanc, nga çdo ngjarje, rrethanë apo Force Madhore, brenda kufijve të përgjegjësisë që mbulohen me sigurim, jo me pak se 70% të vlerës së investuar. Për këtë qëllim, Shoqëria Koncesionare do të paraqesë çdo vit pranë Autoritetit Kontraktues dokumentin përkatës që vërteton sigurimin, lëshuar nga institucioni përkatës.
- 41.2 Sigurimi do të kryhet në përputhje me Ligjin Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit".

#### **Neni 42**

##### **Garancitë e Autoritetit**

- 42.1 Autoriteti deklaron dhe garanton se, që nga data e kësaj Kontrate dhe gjatë Periudhës së Koncesionit:
- a) Ai ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet nën këtë Kontratë;



- b) Kjo Kontratë përbën detyrimin e tij ligjor, të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues që parashikohet në përputhje me kushtet e saj;
  - c) Do të mbrojë dhe nuk do të dëmtojë Koncesionarin nga të gjitha pretendimet juridike të palëve të treta në lidhje me zotërimin paqësor (prosedimin si pronë) të vendeve dhe aseteve të Koncesionit;
- 42.2 Autoriteti Kontraktues merr përsipër të garantojë Koncesionarin, në lidhje me ekzekutimin e veprave të tjera të ngjashme, në përputhje me dokumentat standarde dhe planin e biznesin, duke mos marrë në konsideratë asnjë kërkesë që cënon rentabilitetin, përshtatshmërinë financiare dhe vlerën në para të këtij investimi.
- 42.3 Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit, merr përsipër të ndihmojë dhe asistojë këtë të fundit në marrëdhëniet me të tretët, në mënyrë që të shmangët çdo pengesë, për t'i siguruar Koncesionarit një gëzim të qetë të Portit dhe sheshtit ku do të kryhen punimet në tokë, për realizimin e punimeve dhe operimin normal për realizimin e Projektit.

### Neni 43

#### Garancitë e Koncesionarit

- 43.1 Koncesionari deklaron dhe garanton tek Autoriteti se, që nga data e pajisjes me dokumentacionin e nevojshëm dhe gjatë Periudhës së Koncesionit:
- a) Ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet nën këtë Kontratë dhe për të kryer transaksionet e parashikuar në të;
  - b) Ka pozitë dhe kapacitetin financiar për të ndërmarrë Koncesionin;
  - c) Do të përmbushë detyrimet e tij me zellin e duhur profesional;

### Neni 44

#### Sigurimi i Kontratës

- 44.1 Koncesioneri, me shpenzimet e tij, do t'i sigurojë Autoritetit një Sigurim Kontrate të lëshuar nga një institucion bankar, që ushtron aktivitetin e saj, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për një shumë të barabartë me 10 % të vlerës totale të investimit, sipas formës së parashikuar në Shtojcën 18 të dokumentave Standarte.
- 44.2 Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Koncesionerit gjatë gjithë periudhës koncesionare.
- 44.3 Autoriteti do të kthejë Sigurimin e Kontratës për Koncesionarin pas kalimit të një periudhe prej 90 ditësh që nga data e mbarimit apo kalimit të kësaj Kontrate me kusht që Koncesionari të mos jetë në kushtet e mospërmbushjes së

detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate. Koncesionari me shpenzimet e tij, i ka dorëzuar Autoritetit Sigurimin e Kontratës të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për një shumë të barabartë me 10% të vlerës totale të investimit, sipas Aneksit 5 të kësaj Kontrate.

- 44.4 Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin e detyrimeve deri në përfundimin e afatit të kësaj kontrate, në mënyrën dhe afatet e rëna dakord në këtë Kontratë dhe/ose Aneksat e saj.
- 44.5 Në rast se zgjidhja rezulton nga një Mos përmbushje e Koncesionarit siç parashikohet në këtë Kontrate, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë nga Garancia e Kontratës deri në atë shumë sa të mbulojë dëmet, pa i cenuar të drejtën Autoritetit Kontraktues për të kërkuar zhdëmtimin e dëmeve përtej shumave të marra nga Garancia e Kontratës.

## Neni 45

### Nën-kontraktimi

- 45.1 Koncesionari ka të drejtë të zhvillojë punime të ndryshme me nënkontraktim pas miratimit nga Autoriteti në përputhje me planin e biznesit. Furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dërgesave nuk do të konsiderohen nënkontraktorë sipas kësaj Kontrate.
- 45.2 Koncesionari ka të drejtë të zhvillojë punime të ndryshme me nënkontraktim me kërkesë të Autoritetit Kontraktor në përputhje me planin e biznesit.
- 45.3 Me kërkesë të Autoritetit Kontraktor Koncesionari mund të japë kontrata që janë minimalisht 30% e vlerës totale të kontratës së koncesionit tek palët e treta. Per sa i perket nën-kontraktimit do të zbatohen dispozitat që parashikon neni 35 i ligjit 125/2013.
- 45.4 Koncesioneri do të pajisë Autoritetin me informacionin e mëposhtëm për nënkontraktuesin e propozuar:
- Emrin e tij dhe adresën;
  - Qëllimet për të cilat nën-kontaktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë qëllimin e çdo shërbimi që do të ofrohet nga nën-kontaktuesi i propozuar; dhe
  - Cdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti.

## Neni 46

### Transferimi i Kontratës

- 46.1 Koncesioneri nuk ka të drejtë të transferojë pjesërisht apo tërësisht të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër me këtë kontratë, përvec se kur një transferim i tillë miratohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

- 46.2 Palët deklarojnë që transferimi i kontratës do të realizohet në përputhje me përcaktimet e Nenit 32 të ligjit 125/2013 Për koncesionet.

## **PËRFUNDIMI I KONTRATËS**

### **Neni 47**

#### **Mbarimi i kontratës**

- 47.1 Kontrata e koncesionit mbaron me përfundimin e afatit 35 vjecar dhe sipas rastit, ne përfundim të afateve të parashikuara në nenin 8.
- 47.2 Mbarimi i kontratës nuk e zhvesh Koncesionerin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

### **Neni 48**

#### **Zgjidhja e kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

- 48.1 Autoriteti Kontraktues mund ta zgjidhë këtë Kontratë, duke i dhënë Konçesionarit një Njoftim për Zgjidhje në qoftë se, ka ndodhur një Rast mos përmbushje nga Konçesionari që është duke vazhduar për më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas dërgimit nga Autoriteti Kontraktues të Konçesionari të njoftimit për këtë Rast Mospërmbushje nga Konçesionari ose ka ndodhur një Rast i Forcës Madhore, i cili vazhdon për një periudhë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj.
- 48.2 Plani i Rregullimit
- Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas dërgimit të njoftimit nga Autoriteti Kontraktues të Konçesionari për ekzistencën e një Rasti Mospërmbushje nga Konçesionari, Konçesionari mund t'i propozojë Autoritetit Kontraktues një Plan Rregullimi. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së tij, Autoriteti Kontraktues do të shprehet nëse e pranon ose e refuzon këtë Plan Rregullimi, si dhe do të njoftojë menjëherë Konçesionarin për refuzimin ose pranimin.
  - Nëse Autoriteti Kontraktues e refuzon Planin e Rregullimit, Konçesionari do të ketë të drejtën e një periudhe 10 (dhjetë) ditore për të ndrequr Rastin e Mospërmbushjes (që nga data e njoftimit për refuzimin nga Autoriteti Kontraktues), periudhë pas së cilës Autoriteti Kontraktues mund ta zgjidhë këtë Kontratë, duke i dhënë Konçesionarit Njoftim për Zgjidhje nëse Rasti përkatës i Mospërmbushjes nuk është ndrequr ende.
  - Nëse Autoriteti Kontraktues e miraton Planin e Rregullimit, miratim i cili nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme, Konçesionarit do t'i kërkohet të zbatojë me përpikmëri këtë Plan Rregullimi. Nëse Konçesionari nuk e ka ndrequr këtë Rast Mospërmbushje në mbarim të periudhës kohore të përcaktuar në Planin e Rregullimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë t'i japë Konçesionarit

Njoftim për Zgjidhje.

- 48.3 Në rast të zgjidhjes së kontratës në mënyrë të njëanshme nga Autoriteti Kontraktues pa asnjë shkak ligjor, Autoriteti do ti njohë Koncesionarit investimin e kryer deri në momentin e zgjidhjes së kontratës. Në lidhje me pretendimet e Koncesionarit për detyrimet e tjera (dëmi i shkaktuar, fitim i munguar) palët deklarojnë se do ti zgjidhin me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente do të jetë Gjykata e Arbitrazhit në zbatim të nenit 63.
- 48.4 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Koncesionari falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

#### **Neni 49**

##### **Zgjidhja e kontratës nga Koncesionari**

- 49.1 Koncesionari mund ta zgjidhë këtë Kontrate duke i dhënë Autoritetit Kontraktues një Njoftim për Zgjidhje bazuar në një Rast Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktues, i cili nuk është kryer brenda 60 (gjashtëdhjet) ditëve nga njoftimi i tij tek Autoriteti Kontraktues ose ka ndodhur një Rast i Forcës Madhore, i cili vazhdon për një periudhë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj.

#### **Neni 50**

##### **Njoftimi i përfundimit**

- 50.1 Secila nga Palët që i japin fund kësaj Kontrate në rastet e parashikuara në të, do ta bëjë këtë me anë të një Njoftimi me shkrim, i cili i dërgohet Palës tjetër (Njoftim Përfundimi). Njoftim Përfundimi duhet të përmbajë :
- a) Detajet e duhura duke nënvizuar Ngjarjen e Shkakut;
  - b) Datën e Përfundimit, e cila duhet të jetë jo më parë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e Njoftimit të Përfundimit;
  - c) Përfundimi i Pagesës, përfshirë dhe hollësite e llogaritjes nga kjo; dhe
  - d) Cdo informacion tjetër të rëndësishëm.

#### **Neni 51**

##### **Procedura e zgjidhjes së mosmarrveshjeve**

- 51.1 Nëse ndërmjet Autoritetit dhe Koncesionerit do të lindë ndonjë çështje që përbën shqetësim, atëherë Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta zgjidhur një çështje të tillë në mënyrë sa më të shpejtë dhe praktike që të jetë e mundshme, në atë nivel që një mosmarrveshje e tillë do të krijohet. Minimalisht, palët do të sigurojnë se e kanë diskutuar çështjen në dritën e fakteve që lidhen me çështjen, që e kanë kaluar atë nëpër nivelet operative, menaxheriale dhe

ekzekutive të shqyrtimit (sipas mundësisë) dhe se kanë bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të arritur në një zgjidhje me mirëkuptim.

## Neni 52

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 52.1 Kur Palët nuk arrijnë një zgjidhje për mosmarrëveshjen, ato do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim, duke përdorur Procesin e Shkallëzimit, përpara nisjes së një procedure alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjes nëpërmjet emërimit të një eksperti apo grupi ekspertësh.
- 52.2 Kur lind një çështje, e cila nuk mund të zgjidhet në atë nivel që kjo çështje lind, atëherë autoritetit ose Koncesionari mund ta dërgojnë atë pranë nivelit tjetër në procesin e Shkallëzimit.
- 52.3 Procesi i Shkallëzimit synon të jetë një udhëzues për palët lidhur me zgjidhjen e çështjeve në mënyrë po aq të shpejtë sa ato lindin. Synimi nuk është që Procesi i Shkallëzimit të funksionojë në mënyrë jo fleksibël apo në një mënyrë të tillë që pengojë zgjidhjen e një çështje në nivelin më të përshtatshëm dhe sa më shpejt që të jetë e mundur.
- 52.4 Kur, në cdo nivel, vendoset që çështja ka kaluar nëpër shkallë sipas mënyrës së duhur, Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta zgjidhur çështjen.
- 52.5 Kur pranohet një zgjidhje, vendimi së bashku me planin e zbatimit do të raportohen me shkrim.
- 52.6 Kur një çështje nuk mund të zgjidhet në një nivel, atëherë ajo do të kalohet në nivelin tjetër më të lartë në përputhje me paragrafin 53.4.

## Neni 53

### Procedura e Shkallëzimit

- 53.1 Përvec rastit kur një çështje kërkon zgjidhje të shpejtë, ku veprimet e Autoritetit janë ose mund të ndikohen negativisht ose kur secila Palë mund të pësojë kosto domethënëse si rezultat i moszgjidhjes së çështjes, referimi i çështjes do të bëhet me raport të shkruar për tek nivelin tjetër nga Pala e cila referon çështjen. Raporti do të përmbajë, të paktën informacionin e mëposhtëm:
  - Emrin dhe adresën e iniciatorit;
  - Data kur është ngritur çështja për herë të parë;
  - Përshkrimi i çështjes, duke përfshirë çdo histori me probleme të ngjashme;
  - Implikimet e çështjes, seriozitetin e saj dhe shkallën e urgjencës që kërkohet;
  - Një vlerësim të kostos aktuale dhe potenciale të çështjes;

– Emrat dhe adresat e të tjerëve të përfshirë, të cilët mund të ketë nevojë të konsultohen.

53.2 Brenda 5 dite pune nga marrja e vendimit për shkallëzimin, iniciatori dhe homologu i tij do të përgatisin dhe pranojnë një raport për nivelin tjetër dhe homologut do t'i jepet një kopje e raportit. Kur raporti nuk mund të pranohet, atëherë cdo vërejtje shtesë që mund të kërkojë Pala tjetër, do t'i bashkëlidhet raportit.

53.3 Sapo raporti të jetë dorëzuar, personat përkatës të nivelit të dhënë do të kontaktojnë me njëri-tjetrin sa më shpejt që të jetë e mundur për të zgjidhur çështjen që është subjekt i referimit brenda një periudhe shtesë prej 5 ditësh pune pas së cilës çështja do të referohet në nivelin pasardhës ose, do të zbatohen, në vijim të referimit të nivelit 4, procedurat e përcaktuara në paragrafët 61.3.

53.4 Nivelet e shkallëzimit janë si vijon:

Niveli	Autoriteti	Koncesioneri
Niveli 1	Njësia e Zbatimit të Projektit	Drejtori i Projektit
Niveli 2	Titullari i Autoritetit Kontraktues	Menaxheri i Përgjithshëm i Shoqërisë Koncesionare

#### Neni 54

##### Penaliteti në rast mospërbushje detyrimesh

54.1 Në rast mos përbushje të detyrimeve kontraktuale nga ana e koncesionarit atëherë ai detyrohet të paguajë penalitet në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë në ditë.

54.2 Pavarësisht nga penaliteti i mësipërm Koncesionari nuk do të zhvishet nga përgjegjësia për të përbushur detyrimin kontraktual.

#### Neni 55

##### Pasojat e Përfundimit

55.1 Mbarimi i afatit të përfundimit, apo të përfundimeve të tjera të kësaj Kontrate (sido që të ndodhë ajo), nuk duhet të çënojë të drejtat apo ligjshmërinë e cdonjëres prej palëve, as dhe hyrjen në fuqi apo vazhdimësinë e ndonjë dispozite në këtë Kontratë, e cila në mënyrë të qartë apo të nënkuptuar, ka si qëllim të hyjë në fuqi apo të vazhdojë të jetë në fuqi pas mbarimit të afatit të përfundimit, ose të përfundimit të pjesshëm, që përfshin pa kufizim dispozitat e nenit 'Konfidencialiteti', 'Kufizimet për Përgjegjshmërinë', Pasojat e Përfundimit,

Ndarja, Kontrata si një e tërë, Ligji rregullues dhe Juridiksioni, duhet të veprojë edhe pas përfundimit apo mbarimit të kësaj Kontrate.

## **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 56**

#### **Marrëveshja e Palëve**

- 56.1 Asgjë në këtë Kontratë nuk ka për qëllim që të krijojë një ortakëri apo një marrëdhënie ligjore të cfarëdo lloji që mund të shtonte përgjegjësi mbi njërën Palë për veprimin apo mosveprimin e Palës tjetër apo që të autorizonte secilën nga Palët që të veprojnë si agjentë për Palën tjetër. Asnjëra nga palët nuk do të ketë autoritetin që të bëjë përfaqësime apo të veprojnë në emër të Palës tjetër apo të angazhojë palën tjetër në cfarëdo mënyre.

### **Neni 57**

#### **Ndarja**

- 57.1 Nëse cilado nga dispozitat e kësaj Kontrate vlerësohet si e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme për cfarëdo arsye dhe nga cilado gjykatë apo juridiksion kompetent, kjo dispozitë do të ndahet pa sjellë pasoja për dispozitat që mbeten. Nëse një dispozitë e kësaj Kontrate që është themelore për përmbushjen e qëllimit të kësaj Kontrate gjykohet se është e pavlefshme në cfarëdo shtrirje, Koncesionari dhe Autoriteti do të fillojnë menjëherë negociatat në mirëbesim për ta rregulluar këtë pavlefshmëri.

### **Neni 58**

#### **Sigurime të mëtejshme**

- 58.1 Secila Palë merr përsipër me kërkesën e Palës tjetër dhe me shpenzimet e Palës që e kërkon që të kryejë të gjitha veprimet dhe të sigurojë të gjitha dokumentat që mund të jenë të nevojshme për ti dhënë fuqi kuptimit të kësaj Kontrate.

### **Neni 59**

#### **Kontrata si një e tërë**

- 59.1 Kjo Kontratë, së bashku me dokumentat bashkëngjitur, përbën Kontratën si një e tërë në lidhje me çështjet e trajtuara në të dhe sundon mbi, zhvlerëson dhe shfuqizon cdo Kontratë të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me çështje të tilla pavarësisht nga termat e cilitdo rregullim apo cilësdo kontratë të mëparshme që kanë shprehur se nuk do të përfundojnë.

- 59.2 Secila nga palët njeh dhe bie dakort se me hyrjen në këtë Kontratë dhe në dokumentat e referuar në të, ajo nuk do të përfitojë asnjë dëmshpërblim në lidhje me këtë, cfarëdo deklarate, përfaqësimi, garancie apo detyrimi të marrë përsipër (qoftë e bërë nga neglizhenca apo pa faj) të ndryshme nga sa është thënë në mënyrë të shprehur në këtë Kontratë. Rregullimi i vetëm i mundshëm për secilën palë në këtë Kontratë në lidhje me deklarime, përfaqësime, garanci apo kuptime të tilla do të jenë për raste të shkeljes së kontratës sipas termave të kësaj Kontratë.

## **Neni 60** **Njoftimet**

- 60.1 Cilatdo Njoftime të dhëna sipas apo në lidhje me këtë Kontratë do të jenë me shkrim, të nënshkruara nga apo në emër të Palës që e bën njoftimin dhe do të njoftohet përmes dërgimit personalisht apo dërgimit të regjistruar të parapaguar apo poste të regjistruar në adresën dhe në vëmendjen e Palës përkatëse për këtë qëllim apo në atë adresë që Pala mund të ketë përcaktuar në përputhje me këtë Nen. Njoftimet nuk do të dërgohen me postë elektronike.
- 60.2 Cdo Kërkesë për Ndryshim do të jetë me shkrim dhe e nënshkruar.
- 60.3 Adresat për njoftime dhe komunikime sipas kësaj Kontrate janë:

### **Autoriteti Kontraktues:**

Ministria e Transportit dhe Infrastruktures  
Sheshi "Skënderbej" Nr.5,  
Tirana, Albania.  
Attn: Ministri

### **Konçesionari;**

Shoëria Koncesionare Porti MBM (Multy Buoy Mooring)  
Porto Romano Durrës,

- 60.4 Do të quhet se një njoftim është marrë:
- Nëse është dërguar personalisht, në kohën e dërgimit; dhe
  - Në rast të dërgimit të parapaguar me postë të klasit të parë, tre ditë pune që nga dita e postimit.

## **Neni 61** **Ligji rregullues dhe Juridiksioni**

- 61.2 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.



- 61.3 Cdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.
- 61.4 Në rast se zgjidhja me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë dështon, atëherë mosmarrëveshja mes Palëve do të zgjidhet përmes Arbitrazhit Ndërkombëtar, referuar rregullave të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë Paris (ICC Rules).
- 61.5 Vendi i Arbitrazhit do të jetë Paris, ndërsa gjuha e Arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.
- 61.6 Në rastin e mosmarrëveshjes, në varësi të vlerës së mosmarrëveshjes Palët do të bien dakord në lidhje me numrin e Arbitrave. Në rast se do të jemi para rastit që mosmarrëveshja do të gjykohej nga tre Arbitra, atëherë secila nga palët ka të drejtë të zgjedhë nga një Arbitër dhe së bashku do të bien dakord me Krye Arbitrin, i cili do të ketë nacionalitet të ndryshëm nga Palët në konflikt.
- 61.7 Në rast se palët nuk do të arrijnë të bien dakord, atëherë Krye Arbitri do të zgjidhet nga Sekretariati i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë Paris duke iu referuar në cdo rast rregullave të ICC në fuqi në momentin që kjo Kontratë bëhet efektive.
- 61.8 Fillimi apo vazhdimi i negociatave për zgjidhje me dialog, apo i procedurave gjyqësore nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektivit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

## Neni 62

### **Praktikat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 62.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara.
- 62.2 Koncesionari nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë koncesion/partneritet publik privat.
- 62.3 Koncesionari duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

## Neni 63

### **Hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit**

- 62.1 Kontrata e Koncesionit u hartua në 4 kopje të njëjta në gjuhën shqipe dhe do të hyjë në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, dhe pas botimit në fletoren zyrtare.